



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

**“LËVIZJET ANTIKOLONIALISTE DHE ANTISISTEMIKE NË KOSOVË  
1941-1999”**

MENTOR: PROF. DR. BUJAR DUGOLLI

KANDIDATI: MRIKA LIMANI

PRISHTINË, 2022

Rezume e disertacionit **Lëvizjet antikolonialiste dhe antisistemike në Kosovë 1941-1999** të  
kandidates Mrika Limani

Fokusi i trajtesës në kapitullin e parë të disertacionit qëndron në disa përkufizime themelore terminologjike, teorike, dhe historike, që e vendosin diskursin mbi çështjen thelbësore të parashtruar në këtë disertacion: lëvizjet kundërshtuese si reaksion ndaj një shtypje sistemike. Në këtë kuptim, studimi zhvillohet përreth ideve që lëvizjet kundërshtuese nuk burojnë të ndara nga kontekstit kohor dhe hapësinor në të cilin gjenden, dhe në të shumtën e rasteve përkufizimi i tyre vetëm si lëvizje kundërshtuese e pakëson peshën politike që ato lëvizje kanë mbartë në vete. Duke e vënë në kontekst të zhvillimit të historisë shqiptare në Kosovë, studimi fillon me premisën kryesore (që parashtrohet njëkohësisht edhe si hipoteza e parë) që thotë se sipas vëzhgimeve historike, duket sikur ekziston një vazhdimësi e lëvizjeve kundërshtuese përgjatë historisë së re së Kosovës, të cilat jo gjithëherë kanë ndarë të njëjtin themel politik. Në këtë kuptim, rrjedhë diskutimi te nevoja për t'i shpjeguar këto kundërshtime si anti-kolonialiste apo anti-sistemike. Në këtë aspekt, termi anti-kolonialist ndërlidhet së pari me parimin që disertacioni përvetëson pikëvështrimin e lëvizjeve të cilat trajtohen në studim: lëvizjet anti-fashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore e kanë përjetuar sundimin italian dhe më vonë gjerman si sundim me tipare kolonialiste, të cilat përpos që kanë eksploatuar ekonomikisht popullatën dhe resurset natyrore të vendit, gjithashtu kanë instaluar politika të cilat kanë shkaktuar degradim të sistemit politik dhe dobësim të përgjithshëm të lëvizjeve për pavarësi politike nga shtete imperialiste dhe kolonialiste (terminologji e cila është e pranishme edhe në burimet arkivore të përfshira në trajtesën studimore). Termi “lëvizje anti-koloniale” më tutje përdoret në referencë me lëvizjet me karakter të majtë që shfaqën përgjatë Jugosllavisë së Dytë (Grupi Marksist Leninist, më vonë Organizata Marksiste Leniniste e Kosovës, Partia Komuniste Marksiste Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi, Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi), të cilat në mënyrë eksplicite në trajtesat dhe manifestot e tyre e përshkruajnë rezistencën e tyre kundër sistemit socialist jugosllav si rezistencë kundër një sistemi kolonialist dhe rezistencë që lufton eksploatimin ekonomik, politik dhe kulturor të popullatës shqiptare të Kosovës. Termi anti-kolonial, gjegjësisht anti-sistemik, diferencohen nga njëra tjetra varësisht premisë ideologjike që

këto levizje kanë mbartë në vete: përderisa studimi ndjek vijën lineare të zhvillimit të lëvizjeve anti-kolonialiste si substrat i një de-imperializimi marksist, ndërsa lëvizjet anti-sistemike i parashtron si lëvizje kundërshtuese të një sistemi dallues që është në pushtet dhe ka fuqi. Kjo ndërlidhet me hipotezën e dytë që flet për dallimet ontologjike ndërmjet lëvizjeve anti-kolonialiste dhe anti-sistem, sipas së cilës vërehet se lëvizjet anti-sistemike sipas kontekstit historik të Kosovës, shfaqën më shumë si lëvizje kundër një sistemi politik të vendosur, dhe jo gjithëherë mbartin përbrenda vetës ndonjë ideologji që asocohet me të majtën.

Përmes vendosjes së këtyre koncepteve bazë në kapitullin e parë, ndërtohet një kornizë e diskutimit historik, në të cilën lëvizjet kundërshtuese që i përkasin periudhës 1941-1999 në Kosovë trajtohen si lëvizje që kishin për synim çlirimin nga pushtimi dhe luftimin e një sistemi të caktuar politik, ekonomik dhe social.

Sipas hipotezave dhe pyetjeve kryesore të ngritura në këtë disertacion, studimi ka nxjerrë disa përgjigje që shpesh përkojnë me hipotezat e ngritura që në fillim, mirëpo jo gjithëherë është rasti i tillë. Hipotezat e ngritura në fillim ishin si në vijim:

- 1) Nga perspektiva e historisë së përgjithshme, studimi do të trajtojë nëse ekziston një vazhdimësi e veprimtarisë së lëvizjeve anti-kolonialiste në Kosovë 1941-1999 pavarësisht premisave ideologjike që ato përvetësonin.
- 2) Nëse ekziston një diferencë ontologjike ndërmjet lëvizjeve anti-kolonialiste dhe anti-sistem: Gjegjësisht nëse lëvizjet që mbështetnin socializmin liberal dhe avancimin e pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi ishin specifikisht anti-sistem; dhe nëse lëvizjet që mbështetnin marksizmin enverist dhe avancimin e pozitës së shqiptarëve në relacion me Shqipërinë ishin anti-kolonialiste.
- 3) Nëse dhuna është përdorur si mjet për të fituar kontroll: Dhuna që ka buruar nga entiteti shtetëror tregon humbje të kontrollit, dhe dhuna e ushtruar si përgjigje ndaj represionit ka indikuar përfitim të kontrollit mbi territor të caktuar.
- 4) Studimi do të trajtojë nëse pjesëmarrësit në organizata të majta nga natyra ideologjike kishin bindje marksiste apo nëse mbanin bindje nacionaliste dhe i përvetësonin bindjet ideologjike marksiste vetëm sipërfaqësisht si pasojë e kontekstit socio-politik në të cilin ndodheshin;

Nga të dhënat e trajtuara në këtë studim, shohim që në fakt grupet të cilat kishin përdorur dhunë më shumë kishin fituar më shumë kontroll dhe pushtet. Kjo përkon me hipotezën e tretë të ngritur në kapitullin e parë, ku e shohim mënyrën sesi italianët dhe gjermanët fillimisht kishin vendosur pushtet përmes dhunës ndaj civilëve, dhe dhunës ndaj kundërshtarëve në veçanti, gjë që si hipotezë përputhet vetëm për periudhën e Luftës së Dytë Botërore.

Te grupet gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjithashtu e shohim tek diskursi anti-kolonialist të zhvillohet në disa drejtime: Së pari grupet nacionaliste që ishin kundër pushtimit italian (legalistët, Kryezinjët), grupet nacionaliste që ishin kundër pushtimit jugosllav dhe komunistëve (Balli Kombëtar), dhe së fundi grupet komuniste që ishin kundër fashistëve dhe nazistëve. Në këtë drejtim, e shohim që vëzhgimet tona nuk përkojnë plotësisht me hipotezën e dytë të ngritur në kapitullin e parë, të paktën jo sa i përket konjunkturës historike të Luftës së Dytë Botërore. Nga vëzhgimet tona, me një liri të theksuar teorike, e shohim që diskursi anti-kolonialist mund të burojë nga një ligjërime i kundërshtimit të pushtuesit, pa përvetësuar domosdoshmërisht ndonjë ideologji qendrore me konotacione të anti-imperializmit evropian. Megjithëse dimensionet përkufizuese të anti-kolonializmit të komunistët/partizanët dallojnë nga ato nacionaliste, në thelb që të dy grupimet qendrore e kanë luftën kundër pushtimit. Sa i përket dallimeve ontologjike ndërmjet përkufizimeve anti-kolonialiste dhe anti-sistem, mund të argumentohet që vetëm njëra nga këto grupime që ishin aktive gjatë luftës, respektivisht komunistët, kishte kundërshtim ndaj sistemit politik, ekonomik, dhe shoqëror të vendosur gjatë luftës. Në këtë kuptim, e shohim që anti-kolonializmi komunist merr edhe karakter anti-sistem, megjithëse kjo nuk duket të ketë qenë pikënisja kryesore e kundërshtimit sa i përket pjesëmarrësve vendas në këtë lëvizje.

Te grupet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në strukturën mbi-hierarkike të përkohësisë së kundërshtimit, Organizata Nacional Demokratike në veçanti, dhe organizata e tjera kundërshtuese, marrin karakter anti-sistemik, sepse nga të dhënat historike që na parashtrohen vërehet që anëtarët e kësaj organizate kishin për synim luftimin e çetnikëve dhe komunistëve, të cilët i trajtonin si kundërshtarë ideologjik. Për anëtarët e Organizatës, ishte e qartë që sundimi ushtrohej të shqiptarët nga dy struktura sistemike të ndryshme: strukturat nacionaliste serbe dhe malazeze të cilat po e ndiqnin një trajektore historike të luftimit të shqiptarëve (pavarësisht bindjes ideologjike) të shtyrë nga sentimente anti-shqiptare; dhe struktura sistemike e komunistëve/partizanëve, të cilët i luftonin elementet nacionaliste shqiptare si kundërshtarë

ideologjikë, por padyshim që përbrenda këtyre grupeve kishin depërtuar edhe elementet nacionaliste sllave – elemente që riprodhojnë sentimente anti-shqiptare në vetvete. Në këtë kontekst, NDSH bën pjesë në një konjunkturë historike që ndërthuret me periudhën e Luftës së Dytë Botërore dhe njëkohësisht e tejkalon atë si konjunkturë historike në vete. Kjo për faktin se është e qartë që aktiviteti politik i NDSH është posaçërisht i rëndësishëm për trajektoren historike anti-sistem të periudhës fillestare të pasluftës dhe vendosjes së pushtetit socialist jugosllav, por në anën tjetër aktiviteti ideologjik venit me përhapjen e literaturës socialiste, e posaçërisht asaj nga Shqipëria, që ndikoi në riformësimin e kundërshtimit brenda kornizave të tjera ideologjike.

Në kapitullin e tretë, kur i diskutojmë lëvizjet anti-sistem dhe anti-koloniale (Komiteti Revolucionar Anti-Revizionist për Bashkimin e Viseve Shqiptare në Jugosllavi me Shqipëri, Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve), sa i përket natyrës së ideve që grupet e kësaj konjunkturë kishin përbrendësuar, bëhet e qartë që anëtarët kishin marrë qëndrim anti-kolonialist kundrejt Jugosllavisë, posaçërisht në raport me diskursin e tyre për eksploatim ekonomik. Të pazakontë nuk e shohim as kolokuialin e dukshëm të majtë të cilin, mes të tjerash, grupi e kishte përdorur edhe në emrin e tyre. Këtu e shohim se në këtë konjunkturë shfaqja e lëvizjeve anti-koloniale përkon me hipotezën tonë të dytë, ku e shohim një dallim ndërmjet grupeve anti-koloniale dhe anti-sisteme përbrenda konjunkturës historike në fjalë. Kjo sepse, grupi nuk ishte për se kundër socializmit si sistem etatizmi, por ishte kundër një sistemi shtypës dhe kolonialist.

Sa i përket lëvizjeve të konjunkturës 1981-199, këtu duhet të tërheqim paralele me teorinë e sitemit-botëror që i jep shtyese hipotezave dhe argumenteve të parashtruara në këtë disertacion. Për marskistët-leninistët shqiptarë të kësaj kohe (OMLK, PKMLSHJ, më vonë LRSSHJ), Kosova ishte me të vërtetë periferi përbrenda një shteti që bënte pjesë në ‘Botën e Dytë’, ose semi-periferinë e Wallersteinit. Vetë ky pozicionim hedh dritë mbi diskursin anti-kolonial që këto organizata përbrendësonin, gjë që na jep një ndihmesë në përkufizimin e tyre si grupe anti-kolonialiste dhe pjesë e një lëvizjeje me karakter të tillë. Për më tepër, kjo tregon se edhe te lëvizjet kundërshtuese kishte dallime ontologjike ndërmjet lëvizjeve anti-sistem dhe atyre anti-koloniale, që nisej nga vetë ideologjia që përvetësonin dhe metodat që i përzgjidhnin për të shtyrë përpara kauzat e tyre. Kjo përkon me hipotezat e këtij disertacioni të ngritura në fillim, gjegjësisht me hipotezën e dytë që thekson se ka dallime ontologjike ndërmjet lëvizjeve anti-sistem dhe anti-kolonialiste. Në këtë trajektore e shohim që lëvizjet anti-kolonialiste, qëndrim ky i qartë në tezat e tyre, kishin karakter të çlirimit anti-kolonial dhe nuanca të qarta marksiste.

Sa i përket luftës anti-koloniale në vitet e '90, këtu shohim qartazi që lëvizjet kundërshtuese (LPRK, LKÇK) që i përkasin kësaj konjunkturë historike kishin të përbashkëta ideologjike dhe një platformë shumë të ngjashme ushtarake/politike përmes së cilës synonin t'i arrinin qëllimet e tyre politike. Sërish këtu e shohim që diskursi i tyre anti-kolonial i jep një karakter të qartë të tillë dhe identiteti i majtë, e më specifikisht marksist, qëndron në pajtim me hipotezën e dytë të ngritur në kapitullin e parë të kësaj temë. Pra, në këtë pikë mund të krahasojmë lëvizjet kundërshtuese që flisnin për një rezistencë paqësore (LDK) dhe që identifikoheshin me rryma më liberale të spektrit politik të cilat në thelb synonin të ndryshonin sistemin që ishte në fuqi. Nëse i aplikojmë përkufizimet e Wallerstein-it e shohim që këto lëvizje kundërshtuese mund të trajtohen si lëvizje anti-sistem. Në anën tjetër, kur i vendosim në diskutim edhe rrymat e tjera të kundërshtimit të cilat ishin me identitet ideologjik marksist dhe përvetësonin revolucionin e armatosur si mjet praktik për arritjen e qëllimeve politike dhe luftimin e një fuqie që ata e konsideronin si koloniale, atëherë kjo përkon gjithashtu me përkufizimet e ofruara në kapitullin e parë. Në këtë mënyrë, ky dallimi ontologjik ndërmjet dy grupimeve vërehet më së qarti në konjunkturën historike nga vitet e '70 deri '90.

Në fund, në të gjitha lëvizjet kundërshtuese të trajtuara në disertacion e shohim një element vazhdimësie që përsëritet në diskursin politik dhe ideologjik që e përvetësojnë të gjitha lëvizjet në fjalë dhe kjo mund të interpretohet si një njësi përkohësie e mbi-strukturës së lëvizjeve kundërshtuese.

## **SUMMARY**

The first chapter of this doctoral dissertation focuses on several basic terminological, theoretical and historical definitions, which aim to set the discussion on the essential matter presented in this dissertation: If the opposing movements emerge as a reaction from a systemic oppression. In this regard, the study is developed with the idea that the opposing movements do not loom as separate movements from the temporal and spatial context in which they occur, and that in most cases defining them as mere opposing movements decreases the political weight that these movements hold. When this notion is applied within the context of Albanian history in Kosovo, the study is set up with the main premise (which is also suggested as the first hypothesis) which says that according to historical observations it appears that there is a continuity between the opposing

movements throughout the new history of Kosova, of which movements not all of them shared the same political foundation. The discussion continues as an attempt to explain these opposing movements as anti-colonial and anti-systemic. The term anti-colonial is related firstly with the principle that the dissertation adopts the perspective of the actors in these movements that are discussed in the dissertation: the anti-fascist movement during the Second World War experienced the Italian and later on the German occupation as one with colonial elements, who economically exploited the local population and the natural resource of the land while also installing policies that caused a degradation of the political system and an overall weakening of the movements that were fighting for political independence from imperial and colonial states (which as a terminology is offered in the archival sources included in this study). The term 'anti-colonial movements' is further on used in reference to those movements that had a distinct leftist nature which emerge throughout the Second Yugoslavia (the Marxist Leninist Group, later on the Marxist Leninist Organization of Kosova, the Communist Marxist Leninist Party of Albanians in Yugoslavia, the National-liberation Movement of Kosova and the Movement for the Socialist Albanian Republic in Yugoslavia), which in their manifestos and treaties describe their resistance against the socialist Yugoslav system as a resistance against a colonial system, and a resistance which fights the economic, political and cultural exploitation of the Albanian population in Kosova. The term anti-colonial and anti-systemic are different from one another in relation to the ideology that these groups adopt: while the study follows the linear description of the development of anti-colonial as a substratum of a Marxist de-imperialization, whereas the anti-systemic movements are presented as opposing movements of the actual system that is in power. This correlates to the second hypothesis presented in the thesis, which assumes that there are ontological differences between anti-colonial and anti-systemic movements, where it is assumed that the anti-systemic movements in Kosova emerge more often as movements against an established political system and they do not necessarily always hold an ideological stance associated with leftist movements.

By establishing these concepts in the first chapter we aim to construct a framework of historical discussion wherein the opposing movements pertaining to the period 1941-1999 in Kosova are treated as movements that aimed for liberation from occupation and oppression and fought against a specific political, economic and social system.

If we return to the hypothesis and questions raised in the first chapter of this dissertation, we see that the study has answered some of the questions that correspond with the hypotheses raised in the beginning; however this was not always the case. The hypotheses raised in the beginning were as follows:

- 1) From the perspective of general history, the study will analyze if there is a continuity in the activities of anti-colonial movements in Kosova in the period 1941-1999 regardless of the ideological premises that these groups adoptes.
- 2) If there is an ontological difference between anti-colonial and anti-systemic movements: Whether the movements that support liberal socialism and the advancement of the position of Albanians in Yugoslavia were specifically anti-system; and if the movements that supported Enverist/Hoxhaist Marxism and the advancement of the position of Albanians in relation to Albania were anti-colonialist;
- 3) If violence was used as a means to gain control: Violence that emerged from a state entity shows loss of control and violence exercised as a response to this repression indicated an increase of control over a specific territory;
- 4) The study will analyze whether the participants in leftist organizations had Marxist convictions or whether they had nationalist convictions and adopted ideological Marxist convictions only superficially as a result of the socio-political context in which they existed.

From the information analyzed in this study, we notice that in fact groups who had used more violence had gained more control and power. This corresponds to the third hypothesis as raised in the first chapter, where we see the way in which Italians and Germans initially had established power through violence against civilians and against their counterparts in particular, which as a hypothesis matches only the period of the Second World War.

In the groups during the Second World War, we also see the anti-colonial discourse developing in several directions: First the nationalist groups that were against the Italian occupation (legalists, Kryezinjtë), the nationalist groups that were against the Yugoslav occupation and the communists (Balli Kombëtar), and finally the communist groups that were against the fascists and the Nazis. In this regard, we see that our observations do not fully coincide with the second hypothesis raised in the first chapter at least not in terms of the historical



conjuncture of World War II. From our observations, with a pronounced theoretical freedom, we see that anti-colonial discourse can stem from a discourse of opposition to the occupier, without necessarily adopting any central ideology with connotations of European anti-imperialism. Although the defining dimensions of anti-colonialism among communists / partisans differ from nationalist ones, in essence both central groups develop a struggle against occupation. As for the ontological differences between the anti-colonial and anti-system definitions, it can be argued that only one of these groups that was active during the war, namely the communists, had opposition to the political, economic, and social system established during the war. In this sense, we see that communist anti-colonialism also takes on an anti-system character, although this does not seem to have been the main starting point of the opposition as far as the local participants in this movement are concerned.

In the groups that emerged after the end of the Second World War, in the supra-hierarchical structure of temporality, the National Democratic Organization in particular, and other opposition organizations, take on an anti-systemic character. This is because the historical data presented to us show that the members of this organization aimed to fight the Chetniks and communists, whom they treated as ideological opponents. For the members of the Organization, it was clear that the oppression was exercised among the Albanians by two different systemic structures: the Serbian and Montenegrin nationalist structures, which follows a historical trajectory of the Albanian struggle (despite ideological convictions) driven by the Albanian nationalist sentiment; and the systemic structure of the communists / partisans, who fought the Albanian nationalist elements as ideological opponents, and that within these groups the Slavic nationalist elements had penetrated - elements that reproduce the anti-Albanian sentiment in itself. In this context, NDSH is part of a historical conjuncture that intertwines with the period of Second World War and at the same time goes beyond it as a historical conjuncture. This is because the political activity of the NDSH is especially important for the historical anti-systemic trajectory of the initial post-war period and the establishment of Yugoslav socialist power, but on the other hand ideological activity fades with the spread of socialist literature, especially that from Albania, which influenced the reshaping of opposition within other ideological frameworks.

In the third chapter, when we discuss the anti-system and anti-colonial movements (Revolutionary Anti-Revisionist Committee for the Unification of Albanian Territories in Yugoslavia with Albania, Revolutionary Movement for the Unification of Albanians), regarding the nature of the ideas that the groups of this conjuncture had internalized, it becomes clear that the members had taken an anti-colonial stance towards Yugoslavia, especially in relation to their discourse on economic exploitation. We do not see even the visible leftist colloquial as unusual which, among other things, the group had used in their name. Here we see that in this conjuncture the emergence of anti-colonial movements coincides with our second hypothesis, where we see a difference between anti-colonial and anti-systemic groups within the historical conjuncture in question. This is because the group was not entirely against socialism as a system of statism but was against an oppressive and colonialist system.

As for the movements of the conjuncture 1981-199, here we must draw parallels with the theory of world-system that gives impetus to the hypotheses and arguments presented in this dissertation. For the Albanian Marxist-Leninists of this time (OMLK, PKMLSHJ, later LRSSHJ), Kosova was really the periphery within a state that was part of the 'Second World', or the semi-periphery as Wallerstein calls it. This very position sheds light on the anti-colonial discourse that these organizations internalized, which gives helps us in defining them as anti-colonial groups and part of a movement of such a character. Moreover, this shows that even in the opposing movements there were ontological differences between the anti-systemic and anti-colonial movements, which started from the very ideology they adopted and the methods they chose to advance their causes. This coincides with the hypotheses of this dissertation raised at the beginning, namely with the second hypothesis which states that there are ontological differences between anti-systemic and anti-colonialist movements. In this trajectory we see that the anti-colonial movements, a clear position in their theses, had the character of anti-colonial liberation and clear Marxist nuances.

Regarding the anti-colonial war in the 90s, here we see clearly that the opposing movements (LPRK, LKÇK) belonging to this historical conjuncture had ideological commonalities and a very similar military / political platform through which they aimed to achieve their political goals. Again, here we see that their anti-colonial discourse gives them a clear leftist identity, and more specifically Marxist, which stands in line with the second hypothesis raised in the

first chapter of this thesis. So, at this point we can compare the opposing movements that spoke of a peaceful resistance (LDK) and that were identified with more liberal currents of the political spectrum which essentially aimed to change the system that was in power. If we apply Wallerstein's definitions, we see that these opposing movements can be treated as anti-systemic movements. On the other hand, when we question the other currents of opposition which had a Marxist ideological identity and adopted the armed revolution as a practical means of achieving political goals and fighting a power that they considered colonial, then this coincides also with the definitions provided in the first chapter. In this way, this ontological difference between the two groups is most clearly observed in the historical conjuncture from the '70s to the '90s.

Lastly, in all the opposing movements analyzed in the dissertation we see an element of continuity that is repeated in the political and ideological discourse that assimilates all the movements in question and this can be interpreted as a temporality of the superstructure of the opposition movements. Their discourse, in essence, always focuses on the liberation and change of their status as oppressed, which coincides with the first hypothesis raised in this dissertation.